



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 16, datë 21.01.2021

PËR
NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 11, DATË 14.01.2021 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative në nenet 2 e 89, 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në informacionin e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë me email-in e datës 15.01.2021 e me shkresën nr. 11 prot., datë 18.01.2021, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Ndryshimin e pikës 2, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë”, paragrafi I, të Vendimit nr.11, datë 14.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me përmbajtjen si më poshtë:

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari (relator), Alma Ahmeti si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Sokol Shehu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; I pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje me dhunë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar sipas nenit 139-25, 278 të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR